

UNIVERSITETI I TETOVËS

Këshilli Mësimor- Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore

Tetovë, 13.12. 2019

Në bazë të neni 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit (nr.15-2580/1) në mbledhjen e mbajtur më datë 11.12.2019 të Këshillit profesional të programit studimor Matematikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të shpallur me datën 03.12.2019 në gazetën “Koha”, “Nova Makedonija” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 11.12.2019 sjell: Vendimin (nr. 15-2586/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje-rizgjedhje të një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës:

- 1. Doc. Dr. Eip Rufati – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Florim Idrizi - anëtar**
- 3. Doc. Dr. Agon Memeti - anëtar**

Në konkursin e shpallur më date 03.12.2019 në gazetën “Koha”, ”Nova Makedonija” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, është paraqitur një kandidat:

- Mr. sc. Avni Rustemi - i angazhuar në kontratë (Part – Time) në Programin studimor Informatikë, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin e Tetovës.**

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, e paraqetë këtë:

REFERAT

Për zgjedhje e një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

I. Shënime biografike të kandidatit Avni Rustemi

Avni Rustemi u lind në 31.01.1993 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në SH.F. “Kirili dhe Metodij” në Tetovë, në periudhën 2003-2007, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjimnazi “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë gjatë periudhës 2007-2011. Studimet universitare i kreu në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor Informatikës në periudhën 2011-2015, ku fiton titullin Inxhinier i diplomuar i informatikës, me notë mesatare **9.88**, dhe shpallet si **student më i dalluar i gjeneratës**.

Në vitin 2014, Forumi Rinor Islam (FRI) në manifestimin e organizuar me rastin e Vitit të Ri Islam – HIXHRI 1436, e shpall Avni Rustemin si student më të dalluar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Tetovës.

Avni Rustemi si student i dalluar me notë mesatare të lartë fiton bursën studentore që nga viti i dytë i studimeve.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistent part-time në Programin studimor Informatikës dhe fiton bursë si student ekselentë studentore për vazhdimin falas të studimeve të ciklit të dytë. Prej vitit 2015 e deri në ditët e sodit ai vazhdon si asistent part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Informatikës.

Më 20 Nëntor 2017, Avni Rustemi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës me notë mesatare **10.00**, me temë të magjistraturës “Modifikimi i algoritmeve për sortim dhe aplikimi i tyre në Big Data”, dhe fiton titullin **Magjistër i Informatikës**.

Aktualisht vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Elektroteknikës dhe Teknologjisë Informative, në drejtimin Elektroteknikë dhe Teknologji Informative, ku vazhdon hulumtimet në sferën e sigurisë së sistemeve kriptografike

bashkëkohore, metodave dhe teknikave që përdoren në ditët e sodit për siguri më të lartë të të dhënave.

II. Përvoja profesionale

Në vitin 2015, pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve, Avni Rustemi si student më i mirë, fiton mundësinë që të jetë pjesë e projektit të madh që organizon kompania Huawei, dhe të jetë pjesë e “Seeds for the future” programit, ku qëndron në një vizitë shkencore në Kinë, ku për një periudhë prej 15 ditëve do të jetë pjesë e seminareve dhe vizitave shkencore nëpër laboratorët e kompanisë Huawei në Kinë, për të cilën më pastaj do ti jepet certifikatë nderi dhe letër rekomandimi nga Ministria e Shoqërisë informatike dhe administratës të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kompanisë Huawei –Maqedoni.

Njëkohësisht kandidati Avni Rustemi gjatë qëndrimit 15 ditor në Kinë, në periudhën prej 14 Shtator 2015 deri më 17 Shtator 2015, do të jetë pjesë e Universiteti të Gjuhëve dhe kulturës në Beijing, ku do të certifikohet për mbajtjen e 24 orëve të plota për mësimin e gjuhës dhe kulturës kineze.

Avni Rustemi në periudhën prej Qershor 2016 deri më Tetor 2017 ka qenë i angazhuar edhe në Qendrën për Provime Shtetërore, si bashkëpunëtor në sektorin e informatikës, dhe në mënyrë direkte ka qenë i involvuar në procesin e provimeve të maturës shtetërore, për dy vite radhazi.

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë fletë rrjedhshëm edhe gjuhën maqedone, gjuhën angleze dhe ka njohuri edhe në gjuhën gjermane. Ka aftësi të mira në sferën e programimit, ku ndër të tjera mund të theksohen, njohje e mirë e gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, njohuri të mira në HTML, CSS, Wordpress, përpunim multimedial.

Ka njohuri edhe në dizajnimin dhe implementimin e databazave (SQL Server, MySQL), njohje të mirë të sistemit operativ LINUX, paketës Office etj. Poashtu kandidati posedon njohuri edhe në Matlab, Javascript, njohje të mirë të inxhinierisë softuerike, veçanërisht në dizajnimin e metodave më efikase dhe efektive për modelim të sistemeve kompjuterike etj.

Avni Rustemi në periudhën prej 24.12.2013 deri më 27.01.2014, realizon praktikë profesionale në Qendrën për Arsime Profesionale dhe Trajnime, për të cilën më pastaj do të shpërblehet me vërtetim për praktikë të kryer.

Ka qenë edhe pjesë e trajnimeve të ndryshme, ndër të cilat do të përmendim disa më me rëndësi si pjesëmarrje në Microsoft Youthspark eventin, në periudhën 21-22 Maj 2014, pjesëmarrje

në eventin e organizuar nga Universiteti i Tetovës dhe kompania Google, të quajtur “Google Your Future : Hackathon”, ku do të shpërblehet me çertifikatë nga Rektori i Universitetit të Tetovës dhe përfaqësuesja e Google, Margaret Fortney.

III. Publikimet shkencore

Kandidati Mr.sc. Avni Rustemi ka publikuar punime shkencore si vijon:

- Eip Rufati, Avni Rustemi “**A problem that has affected society: Video games addiction**” 3rd International Conference of Natural Sciences and Mathematics (abstract), 15-17 May, 2019, University of Tetovo, Tetovo
- Florim Idrizi, Avni Rustemi, Fisnik Dalipi; “**A new modified sorting algorithm: A comparison with state of the art**”, 2017 6th Mediterranean Conference on Embedded Computing (MECO), IEEE, Bar, Montenegro.
- Festim Halili, Ilia Ninka, Avni Rustemi ,Merita Kasa Halili; “**Finding CPM and PERT for implementing a service ranking model**”; Bulletin of Natural Sciences, Faculty of Science Tirana, ISSN:2305-882X, issue. 14, 2014.
- Avni Rustemi, Nderim Zeqiri, “**Analysis and flexibility of interoperability between application program and database**”, Second International Conference of Applied Sciences,13 May 2016, University of Tetovo, Tetovo.
- Festim Halili, Avni Rustemi, “**Bringing semantics to services: the OWL-s approach**” , Bulgarian Journal for Engineering Design, BJED, issue 30, October 2016, pg. 17-25, ISSN:1313-7530.
- Florim Idrizi, Avni Rustemi, “**Analysis of some several elements of cryptography and proposing a new model for data security**”, BJED, issue 30, October 2016, pg. 57-61, ISSN:1313-7530.
- Festim Halili, Avni Rustemi, “**Modeling of an e-business system**”, International Journal of Computers and Technology, IJCT, Vol. 15 No.12, October 2016, pg.7308-7315, ISSN:2277-3061.
- Festim Halili, Avni Rustemi, “**Importance of Data Mining techniques for the development of business**”, 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics (abstract), 16-17 June, 2017, University of Tetovo, Tetovo.

III. Përfundim dhe propozim

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur, kandidati i plotëson kushtet ligjore edhe profesionale sipas nenit 170 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018)

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore – shkencore, publikimin punimeve shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare dhe përvojës në punën arsimore, notën mesatare gjatë studimeve të ciklit të parë **9.88** dhe ciklit të dytë **10.00** komisioni recenzues ka nderin dhe respektin ti propozojë Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore që kandidati **Avni Rustemi** të zgjidhet në thirjen Mësimore - Shkencore **ASISTENT** për lëndët mësimore në fushën e informatikës.

Komision recensues:

1. **Doc.Dr. Eip Rufati** - kryetar
2. **Prof.Dr. Florim Idrizi** - anëtar
3. **Doc. Dr. Agon Memeti** - anëtar

Tetovë, 13.12.2019